



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**  
**DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT**  
**Sektori i Aseteve**

**Projekt Vendim**

Nr 06. Datë 08.10.2021

**Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të pasurisë nr 663(pjesë), Zk nr 2708, për antenë celulare, në fshatin Mnelë e Vogël, subjektit “ALBtelekom” Sha.**

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar. Në VKM nr 10, dt 07.01.2005, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Vig Mnelë”, në VKM nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

**VENDOSI :**

1. Miratimin e rinovimit të kontratës së lidhur me dt 13.01.2014, për dhënie me qira te pasurisë nr 663(pjesë), Zk 2708 me sipërfaqe 150 m2 për antenë celulare, subjektit ALBtelekom Sha, sipas raportit teknik, relacionit dhe hartës bashkëlidhur.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen në investime publike.
3. Vlera e dhënies me qira të jetë sipas raportit teknik bashkëlidhur, bazuar në VKM-së Nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

**KRYETARI**  
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/ KRYETARI**  
**Lestinë NDOJA**



Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: Ndoc Baqli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT**  
**Sektori i Aseteve**

Nr -----Prot

Vau Dejës me -----,-----2021

**RELACION**

**RINOVIM KONTRATE PËR DHËNIE NË PËRDORIM SUBJEKTIT “ALBTELEKOM”, Sh.a,  
STACIONI NR SH 1008 MNELË E VOGËL PËR ANTENË TË TELEFONISË CELULARE**

**Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, është edhe dhënia në përdorim me apo pa konkurim e pronave të saj të tretëve.

Shoqëria “**Albtelekom**” **sha.a me** shkresën nr 2032/1 prot, datë 23.04.2021, administruar pranë Bashkisë Vau Dejës, më nr 2105/1 datë 12.05.2021, ka kërkuar rinovimin e kontratës së qirasë, për përdorimin e truallit në pasurinë nr 663, Zk 2708 ne fshatin Mnelë e vogël, stacioni **nr SH1008**. Kjo kontrate ka qenë e lidhur me afat 7 vjeçar dhe nga ana e tyre është kërkuar rregullimi i sipërfaqes, pasi pretendonin se sipërfaqja faktike në terren, është më e vogël se ajo që ishte përcaktuar në kontratën pararendëse. Nga verifikimi i bërë në terren me urdhër pune, pasqyruar kjo edhe në raportin tekniko-ekonomik bashkëlidhur dokumenteve të këtij projekt vendimi, rezulton se sipërfaqja që do jepet në përdorim Subjektit”ALBtelekom, sipas plan rilevimit të bërë nga topografi i caktuar në urdherin e punës, është 150 m2, me çmim qiraje 180 lekë/m2 në muaj, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi. **Në total vlera vjetore është 324 000 lekë.**

Nga ana e Sektorit të Aseteve është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për këtë sipërfaqe, tarifat dhe llogaritja e qirasë vjetore, të bazuara në VKM nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim (me qira), me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi për shfrytëzimin e sipërfaqes së truallit, pasuria nr 663, Zk 2708, pasi rezultojne nryshime të sipërfaqes dhe të vlerës siç jane cituar më sipër.

Duke ju falenderuar, ju ftojme të miratoni projekt vendimin.

Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: Ndoc Baqli

## RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISË SË LLOJIT "TRUALL" NË PRONËSI TË BASHKISË VAU DEJËS**

RINOVIM KONTRATE TË DHËNIES ME QIRA TË PASURISË NR 663(PJESË), ZK 2708, SUBJEKTIT "ALBtelekom" Sh.a, STACIONI MNELË E VOGËL, SH 1008 PËR ANTENË TË TELEFONISË CELULARE

Bazuar në Urdhërin nr 175 datë 25.05.2021 të Kryetarit të Bashkisë "Për ngritjen e grupit të punës, për verifikimin në terren të pronës ku janë të vendosura antenat celulare të Shoqërisë ALBtelekom në fshatin Mnelë e Vogël", grupi i punës i përbërë nga; Ndoc Baqli Përgjegjës sektori Aseteve, Martin Krepi Administrator i Njesisë Vig Mnelë, Esmeraldo Harapi ing topograf sek/kadastres, pasi shqyrtoi edhe kërkesën e subjektit Shoqëria "ALBtelekom" realizoi verifikimin në terren të pasurisë, objekt i dhënies në përdorim për vendosje antene të telefonisë celulare.

Pasuria nr 663, Zk 2708 me sipërfaqe të përgjithshme 29180 m<sup>2</sup>, (Truall+ ndërtesë), është në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, me çertifikatë pronësie nr 2045946, datë 28.04.2020. Nga verifikimi dhe matjet e sakta të kryera në terren nga grupi i punës rezulton se në pasurinë nr 663, Zk 2708, e llojit **Truall**, janë të vendosura antenat celulare të shoqërisë "ALBtelekom" Sha, bashkë me pajisjet ndihmëse në funksion të ushtrimit normal të aktivitetit të saj, në një sipërfaqe prej 150 m<sup>2</sup>, ( bashkëlidhur plan rievimi i pronës ).

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim të kësaj pasurie, mbështeten në VKM nr 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar. Në Kapitullin III, pika 2, përcaktohet se; Kur jepet me qira truall i lirë, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysheme e qirasë mujore është 100 lekë/m<sup>2</sup>. Për efekt llogaritjeje, në këtë rast do merret parasysh tarifa prej 180 lekë/m<sup>2</sup> në muaj. Për sipërfaqen prej 150 m<sup>2</sup>, vlera vjetore e qirasë është:

$$\text{Sip} = 150 \text{ m}^2 \times 180 \text{ L/m}^2 \text{ në muaj} = 27\,000 \text{ lekë} \times 12 \text{ muaj} = 324\,000 \text{ lekë/vit.}$$

Pas miratimit të projekt vendimit, Shoqëria do nënshkruaje kontratën me Bashkinë Vau Dejës, për sipërfaqen prej 150 m<sup>2</sup> që jepet me qira me afat deri në 1 vit, me të drejtë rinovimi.

Hartuesit e Raportit Teknik

Jurist; Armand Filipi

Ing Esmeraldo Harapi

P/sektorit Aseteve; Ndoc Baqli





NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI


Lestinë NDOLLA


KRYETARI

Mark BABANI



# PLAN RILEVIMI

<p>PERGATITI: Emer Mbiemer: Esmeraldo Harapi Data e pergatitjes: 03.06.2021</p> <p><u>Siperfaqe:</u> S=150 m<sup>2</sup> (objekti Altelecom)</p> <p> Vula Firma</p>	<p><u>IDENTIFIKIMI I PASURISE</u> ZONA KADASTRALE : 2708 NUMRI I PASURISE : 663 VOL. 3 FQ. 163 INDEKSI I HARTES : K - 34 - 76 - (23 - D) SHKALLA : 1:1000</p> <p>ADRESA E PASURISE: Fshati Mnele e Vogel Rrethi Shkoder</p> <p>PRONARI: BASHKIA VAU DEJES</p>	
--	---	---





DREJTORIA VENDORE  
SHKODËR



ZONA KADASTRALE : 2708

NUMRI I PASURISE: 663

VOL.

FAQE

INDEKSI I HARTES : K-34-76-(23-D) SHKALLA : 1: 2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODËR Q/F: MNELE E VOGEL

B.KUFIZIMET

V. ----

L. 664

J. ----

P. ----

PRONARI

BASHKIA VAU DEJES

Siptr.-29180m2 nga kjo: S.nd.-250m2

Ing . Erjeta Ramaj

Dt. 24.04.2020



2708

MNELE E VOGEL  
663

664

664

2

MNI

**KONTRATE QERAJE**

Mbeshtetur ne vendimin Nr.1064 date 5.2.2010 per Per disa ndryshime ne Vendimin Nr.391 date 21.06.2006 te Keshillit te Ministrive "Per percaktimin e tarifave ne sektorin.e.pyjeve dhe te Kullotave"

Ne mbeshtetje te nenit 100 Kushtetutes ,te pikes 5 te nenit 17 te ligjit9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosore" te ndryshuar dhe nete nenit 34 te ligjit nr.9385,date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjore" te ndryshuar ,me propozim e Ministrit te Mjedisit .Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave ,Keshilli i ministrave.

Sot me date 31.01.2014, u paraqiten personalisht palet si me poshte te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote perpiluan kete Kontrate qeraje:

**Komuna Vig-Mnele** Qarku Shkoder perfaqesuar ligjerisht nga Kryetari i Komunes Z.Pjeter Lleshi , i biri i Zefit shtetas shqiptar, lindur ne Vig-Mnele Shkoder dhe banues ne Vig-Mnele Shkoder me numer ID G60408200E , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili ketu e ne vazhdim do te quhet "Qeradhenesi"

Dhe

**Albtelecom sh.a.** shoqeri anonime shqiptare, regjistruar si person Juridik ne baze te vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, nr. 20820, date 16.02.1999 me seli ne adresen Rr. "Myslym Shyri", Nr' 42, Tirane, Shqiperi, me Nr' NIPTi J61824053N e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem **Z. Erkan Tabak**, shtetas turk, lindur ne Izmir, Turqi, me date 29.11.1971, i pajisur me pashaporte Nr' U 00 69 08 45 i cili perfaqesohet ligjerisht nga **Z. Zamir Cungu**, i biri i Selimit , shtetas shqiptar, lindur ne Shkoder dhe banues ne Tirane, Shqiperi, me 21/03/1974, i pajisur me leternjoftimin Nr' 029577351, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne baze te Prokures se Posacme nr. 99 Rep., Nr. 53 Kol, date 09.01.2014 (dymije e katerbedhjete) hartuar nga Notere Violeta Sulkaj , anetare e Dhomes se Notereve, Tirane, ketu e ne vazhdim do te quhet "Qeramarresi",


Se bashku referuar si "Palet";

te cilet, me vullnetin e tyre te lire nenshkruajne kete kontrate me kushtet e meposhtme:

**Deklarimet Paraprake**

Qeradhenesi deklarone se eshte Pronar i Prones prej 300 m<sup>2</sup>, e ndodhur ne Zonen Kadastrale me numer pasurie 663 prone shteterore ne Fshatin Vig-Mnele Shkoder (Prane Shkolles 8-Vjecare "Mnele e Vogel" ne administrimin e komunes Vig-Mnele , Shqiperi, bazuar ne dokumentacionin ligjor qe eshte i vlefshem ne lidhje me kete prone e cila verteton se Qeradhenesi eshte Pronari i saj.

Qeramarresi deklarone se nepermjet kesaj Kontrate do te marre me Qera nga Qeradhenesi nje siperafaqe, pavarsisht nga vullumi prej 300 m<sup>2</sup>, (pjese e truallit ) e cila eshte Prone e Qeradhenesit dhe qe do te perdoret per interes te Qeramarresit (ketu e ne vazhdim do te quhet "Prona"), si dhe e rruges qe te con tek prona. Prona eshte e ligjshme, e lire nga cdo barre, hipoteke, detyrime apo pretendime dhe jepet me qera aty ku eshte dhe sic eshte. Qeramarresi



[Type text]


do te marre me qera dhe do te perdore Pronen sipas qellimeve, afateve dhe kushteve te percaktuara sa me poshte vijon ne kete Kontrate.

### Neni 1 Qellimi i kontrates dhe pershkrimi i prones

1. Qellimi i kesaj kontrate eshte marrja me qera dhe perdorimi i Prones, si dhe e rruges qe te çon tek Prona nga Qeramarresi, sipas kushteve te percaktuara ne kete Kontrate.
2. Prona, si dhe rruga qe te con tek prona, do te perdoret nga Qeramarresi dhe/ose nenkontraktoret e tij per te vendosur/implementuar Aparatet Marrese-Dhenese GSM/UMTS/3G dhe pjeset e tyre te cilat do te perdoren nga shoqeria Albtelecom sh.a. per ofrimin e sherbimeve te saj qe do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem te aparatet, antena, kulla, kablllo, fibra optike (qe lidhin antenen me rrjetin kryesor te transmetimit tokesor), tela, gjeneratore por edhe ne pajisje ndihmese, paisje per energjine elektrike, bateri, konteniere, skara metalike, shirita togezues, pllaka metalike dhe paisje te tjera te nevojshme dhe qe kanë lidhje me implementimin dhe funksionimin e Aparateve Marres-Dhenese GSM/UMTS/3G dhe pjeseve te tyre.
3. Qeradhenesi lejon instalimin e skarave metalike, shiritave togezues, kablllove, fibrave optike dhe ndonje pajisje tjeter te nevojshme, mjeteve apo pajisjeve te ndryshme treguese qe perdoren per fushen e tregut dhe per emrin e qeramarresit ne pjesen e fasades se nderteses, ne tarrace dhe/ose ne kolonat vertikale te nderteses si dhe ne prone ose ne rrugen qe te con tek prona, nese eshte e nevojshme dhe pjese integrale te pajisjeve GSM/UMTS/3G.
4. Qeradhenesi garanton se ai eshte pronar i vetem ligjor i Prones dhe se Prona eshte e ligjshme, e lire nga cdo barre, hipoteke, detyrime apo pretendime dhe jepet me qera aty ku eshte dhe siç eshte.
5. Planimetria e prones eshte pjese integrale e kontrates e cila i bashkengjitet kontrates si Aneks.

### Neni 2 Pronesia

1. Qeradhenesi verteton pronesine e Prones se permendur ne kete Kontrate me ane te dokumentacionit ligjor qe eshte i vlefshem ne lidhje me pronesine e tij mbi pronen, i cili nuk eshte fshire, ndryshuar dhe nuk ka shenime te tjera pervec atyre ne interes te Qeramarresit.
2. Dokumentacioni i paraqitur, i cili verteton pronesine e Qeradhenesit mbi Pronen eshte pjese integrale e kontrates dhe i bashkegjitet Kontrates si Aneks.
3. Ne rast se Qeramarresi peson ndonje dem ose humbje per shkak te paleve te treta te cilat pretendojne te jene pronare ose bashkepronare ne nje nga menytrat e parashikuara ne ligj, atehere Qeradhenesi eshte i detyruar te mbaje te pademtuar dhe te





demshperbleje Qeramarresin per demin dhe / ose humbjet brenda nje kohe te arsyeshme, por ne cdo rast kjo duhet te behet brenda 2 (dy) muajve nga momenti berjes se njoftimit nga Qeramarresi. Qeramarresi brenda 2 (dy) javeve nga momenti shkaktimit te demit dhe / ose humbjes, do te plotesoje dhe t'i jape Qeradhenesit nje deklarate te shkruar per humbjet, demet si dhe shpenzimet e tjera te kryera.

4. Ne rast se ka ndryshime ne titullin e pronesise, Qeradhenesi duhet te siguroje dhe garantoje Qeramarresin se kjo kontrate do te vazhdoje te jete e regjistruar dhe do t'i dorezoje Qeramarresit nje deklarate te nenshkruar nga Pronari i ri ku do t'i siguroje se ai do te respektoj kushtet dhe parashikimet e kesaj kontrate.

### Neni 3 Kohezgjatja

1. Kohezgjatja e kontrates do te jete per nje periudhe prej 7(Shtate) vjetesh duke filluar nga 13/01/2014 deri me 13.01.2021 me te drejte rinovimi ne baze te marreveshjes reciproke te te dyja paleve.
2. Palet mund te bien dakort per nje zgjatje te afatit te kontrates duke bere nje njoftim me shkrim 30 dite perpara dates se perfundimit te kontrates.

### Neni 4 Cmimi dhe termat e pageses

1. Qeramarresi do te paguaje nje Qera Vjetore ne shumen 330.000 (Treqindetridhjetemije) leke, ne vit perkundrejt leshimit te fatures perkatese tatimore nga Qiradhenesi per Qiramarresin.
2. Pagesat do te behen nje here ne 6 muaj parapagim. Pagesat do te behet brenda 21 diteve pune qe nga dita e fundit e perfundimit te 12 mujorit te fundit (te meparshem) dhe mbas leshimit te fatures perkatese nga Qeradhenesi.
3. Pagesa e pare e vitit te pare do te behet brenda 21 diteve pune , gjithmone pas leshimit te fatures nga Qeradhenesi.
4. Qeradhenesi nuk do te kerkoje asnje pagese para afatit te percaktuar ne Nenin 4, paragrafi 3.
5. Pagesa do te behet ne llogarine bankare te Qeradhenesit ne Shqiperi.
6. Qiramarresi dhe Qeradhenesi perballojne shpenzimet dhe komisionet bankare, nese ka te tilla, qe lidhen me Bankat e tyre respektive.

Emer, Mbiemer:

Banka:

Llogaria Numer:

IBAN:

Monedha:


Komuna Vig-Mnele Shkoder

Raiffeisen Bank

1404030837

AL79202510020000001404030837,

Lek





[Type text]

7. Ne rast se Qeradhenesi ndryshon numrin e llogarise dhe/ose banken, ai/ajo duhet te njoftoje me shkrim per nje ndryshim te tille te pakten 30 dite kalendarike para se te behet pagesa. Ne rast te kundert, Qeramarresi do te beje pagesen ne llogarine bankare ekzistuese, ku pagesa do te quhet e bere dhe Qeramarresi nuk do te mbaje asnje pergjegjesi ne lidhje me kete.
8. Ne rast mosmarreshje apo konflikti mes Qeradhenesit dhe paleve te treta ne lidhje me Pronen dhe / ose pronesine mbi Pronen e dhene me Qera, Qeradhenesi do te kryeje pagesen ne nje llogari te ndare (te veçante) apo ne nje llogari te percaktuar me nje vendim gjykate apo dokument tjeter detyrues ligjor.
9. Ne çdo rast qeradhenesi nuk do te kerkoje ne asnje menyre pergjate afatit kohor te kesaj kontrate ndryshimin e cmimit te qerase.


#### Neni 5 Tatimet, taksat, detyrimet

1. Cmimi i kontrates perfshin te gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet qe aplikohen ne baze te legjislacionit shqiptar ne lidhje me Qerane mbi Pronen, objekt i kesaj Kontrate.
2. Qeradhenesi do t'i leshoje Qeramarresit faturen perkatese per qeradhenien.

#### Neni 6 Te drejta dhe detyrimet e Qeradhenesit

##### Qeradhenesi:

3. Do te siguroje gezimin e lire dhe te qete te prones, si dhe te rruges qe te con tek prona per Qeramarresin; te punonjesve te tij dhe personave te autorizuar nga Qeramarresi se bashku me mjetet dhe pajisjet perkatese te punes ne Prone, 24 ore ne dite, per 7 dite te javes.
4. Nuk do te beje asnje ndryshim apo ndertim, vete ose nga te tretet, ne dhe brenda prones qe mund te detyroje qeramarresin te spostoje antenen diku gjelke, apo te pengoje, frenoje, veshtiresoje, apo ndikojte sadopak ne aktivitetin e Qeramarresit. Ne rast te ndertimeve apo ndryshimeve, Qeradhenesi do te lajmeroje me shkrim te pakten 3 (tre) muaj perpara dhe duhet te marre miratimin paraprak me shkrim te Qeramarresit para se te procedoje me ndertime, punime apo ndryshime. Ne te tilla raste kostot e spostimit te antenes do paguhen te gjitha nga qeradhenesi, sipas fatures se prere nga qeramarresi, ose ne te kundert do t'i mbahen nga pagesa e qerase se antenes.
5. Nuk do te nderhyje, pengoje dhe nuk do te perzihet ne Aparatin Marres-Dhenes GSM/UMTS/3G, ne shtrimin e fibrave optike, si dhe pjeset e tyre, paisjet apo edhe sistemin e Qeramarresit.
6. Do te lejojte vendosjen e skarave metalike, kabllave tokezues ne fasaden e nderteses, ne tarrace apo ne kolonat vertikale dhe ndonje pajisje tjeter brenda prones, te cilat jane te





[Type text]

nevojshme si pjese e Aparatit Marres-Dhene GSM/UMTS/3G, pjeseve te tyre dhe pajisjeve GSM/UMTS/3G.

7. Do te lejoje Qeramarresin te perdore energjine elektrike derisa Qeramarresi te kete burimin e tij te energjise dhe sahatin mates dhe do te lejoje Qeramarresin qe te vendose burime energjie ne prone. Ne rast mungese apo nderprerje, Qeradhenesi do te furnizoj Qeramarresin me energji nga burime te tjera ose do te lejoje Qeradhenesin te instaloje perkohesisht gjeneratore te levizshem derisa energjia elektrike te rikthehet. Shpenzimet per kete furnizim do te perballohen nga Qeramarresi sipas te dhenave te regjistruara te treguara ne sahatin mates.
8. Do te siguroje se nuk do t'i jape te njejtat te drejta njelloj si Qeramarresi te cilat jane pershkruar ne kete kontrate si edhe per kete prone, konkurenteve te Qeramarresit pa miratimim paraprak me shkrim te Qeramarresit.
9. Ne rast se ndonje ligj ne fuqi kerkon aplikimin personal te Qeradhenesit si pronar i Prones, ai do te aplikojte dhe do te mbeshtese Qeramarresin.
10. Ne rast se Qeradhenesi eshte ne dijeni te veprave apo veprimeve te te treteve qe pengojne, veshtiresojne, apo demtojne pajisjet e instaluara te Qeramarresit, atehere ai do te lajmeroj Qeramarresin sa me shpejt te jete e mundur.
11. Qeradhenesi do te lajmerojte menjehere qeramarresin sapo te ndryshojte adresen e qendrimit te tij apo numrin e celularit.


#### Neni 7 Te drejta dhe detyrimet e Qeramarresit

##### Qeramarresi:

1. Do te perdore pronen vetem per qellimet e parashikuara ne kontrate
2. Mund te beje ndertime ose ndryshime ne prone per arritjen e qellimeve te kesaj kontrate.
3. Do ta mbaje pronen ne kushte te mira dhe do te beje perpjekjet e tij me te mira per te mos e demtuar.
4. Per shkak te arsyeve teknike dhe/ose azhomimit te nevojave teknike, Qeramarresi ka te drejte te beje ndryshime, restaurime apo shtesa, ne prone, te cilat perfshijne por nuk kufizohen vetem te pajisjet shtese te Radio Link, Seti i gjeneratorit, sisteme, etj, te cilat do te jene brenda kufijve te prones dhe qellimit te kesaj kontrate duke mos paguar asnje qera shtese te Qeradhenesi.
5. Do te jete pergjegjes vetem per ato deme qe jane shkaktuar per shkak te instalimit dhe mirembajtjes te Aparatit Marres-Dhene GSM/UMTS dhe pjeseve te tij.

#### Neni 8 Kalimi i kontrates

Asnje nga palet nuk do t'a kaloje apo transferoje me asnje forme kete Kontrate apo ndonje nga te drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj, tek nje person apo entitet tjeter, pjeserisht apo



[Type text]

te teren, pa miratimin paraprak me shkrim te pales tjetër, miratimi i se ciles nuk duhet te vonohet apo refuzohet ne menyre te paarsyeshme.

#### Neni 9 Perfundimi i kontrates nga Qeradhenesi

Qeradhenesi ka te drejte te perfundoje kete kontrate para dates se perfundimit vetem ne rast se: Qeramarresi nuk ka bere pagesen brenda 3 (tre) muajve duke filluar nga data e fundit qe duhet bere pagesa ashtu si parashikohet ne nenin 4 te kesaj kontrate.

#### Neni 10 Perfundimi i kontrates nga Qeramarresi

1. Qeramarresi ka te drejte te perfundoje kete kontrate perpara dates se perfundimit ne rast se:

- Qeradhenesi nuk mund te siguroje/garantoje gezimin e lire dhe te qete te prones dhe rruges te con tek prona nga Qeramarresi.
- Qeradhenesi nuk merr dot leje, miratimi, aprovim nga pushteti dhe /ose agjensite lokale dhe nuk nenshkruan ndonje nga dokumentat ne lidhje me kete kontrate.
- Qeramarresi eshte i detyruar te largohet nga territori i Republikese se Shqiperise per shkak te luftes, trazirave apo ndonje arsyeje te tille.
- Nje perfundim i tille i kontrates eshte i nevojshem per performacen e aktivitetit te tij.

2. Qeramarresi ka te drejte te perfundoje kete kontrate ne cdo kohe duke bere nje njoftim paraprak me shkrim prej 30(tridhjetë) ditesh.


3. Ne rast te perfundimit te kontrates nga cdonjeri prej Paleve, Qeramarresi do te cmontoje dhe heqe pajisjet e tij brenda 30(tridhjetë) ditesh dhe Qeradhenesi nuk do t'a pengojë apo veshtiresojë Qeramarresin ne asnje forme dhe me asnje mjet.

#### Neni 11 E drejta e parablerjes

Ne rast se Qeradhenesi desheron te shese pronen ose nje nga pjeset e saj te cilat perbejne pronen, atehere Qeramarresi ka te drejten e parablerjes.

#### Neni 12 Ndryshimet

Ndryshimet ne kushtet dhe termat e Kontrates mund te behen vetem me marrëveshje me shkrim të palëve. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate është i vlefshëm vetëm nëse është nënshkruar rregullisht nga të dyja palët dhe vetëm pas nënshkrimit nga palët konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj Kontrate. Te gjitha ndryshimet inkorporohen ne Kontrate me marreveshje formale te shkruar.



**Neni 13 Teresia e kontrates**

Kontrata sebashku me te gjitha termat dhe kushtet e saj do te interpretohet si nje e tere. Ne rast te dykuptimesise, paqartesisise apo mosperputhjeve, per shkak te ndonje neni, paragrafi apo fraze, do te interpretohet dhe konsiderohet ne kontekstin e te gjithe Kontrates dhe sipas qellimit per te cilin palet kane lidhur kete Kontrate.

**Neni 14 Gjuha e kontrates**

Kjo Kontrate u hartua ne 19 nene, ne 2 (dy) origjinale te perpiluara ne gjuhen Shqipe, dhe do te interpretohet ne gjuhen Shqipe.

**Neni 15 Njoftimet**

Cdo njoftim ose komunikim qe lind si nevojë e zbatimit te kesaj Marreveshjeje, do te dergohet nga njera Pale me poste te regjistruar tek Pala tjeter, sipas adresave te Paleve te percaktuara ne kete Kontrate:

Adresa e Qeramarresit:           Albtelecom sh.a.  
Adresa: Rr.Myslym Shyri, Nr 42, Tiranë Shqipëri

Adresa e Qeradhenesit:       Komuna Vig-Mnele Shkoder

**Neni 16 Konfidencialiteti**


Palet do te mbajne konfidenciale Kontraten dhe permbajtjen e saj. Perjashtohet nga ky rregull vetem kur Kontrata dhe permbajtja e saj kerkohet detyrimisht me ligj t'u behet e njohur organeve kompetente shteterore.

**Neni 17 Ligji i zbatueshem**

Kontrata, lidhja, nenshkrimi, zbatimi dhe interpretimi, si dhe marrëdhëniet midis paleve, rregullohen sipas ligjeve Shqiptare. Te gjitha kushtet e tjera qe nuk trajtohen ne kete Kontrate jane te zbatueshme per palet sipas akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

**Neni 18 Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

- 1 Palet do te bejne perpjekjet maksimale qe te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga kjo Kontrate, zbatimi dhe interpretimi i saj, te zgjidhen me mirekuptim. Ne te kundert, per te gjitha mosmarreveshjet qe rrjedhin apo jane ne lidhje me kete Kontrate, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata perkatese.
- 2 Nese palet bien dakort, me deshiren e tyre mund t'i drejtohen Arbitrazhit.



**Neni 19 Hyrja ne Fuqi**

Kjo kontrate do te hyje ne fuqi ne ditën e nenshkrimt nga palet, kurse pagesat do te behen ne perputhje me nenin 4 te kesaj Kontrate.

Kontrata nenshkruhet rregullisht nga Palet ne 2(dy) kopje origjinale, ne gjuhen Shqipe.


Per dhe ne emer te Qeradhenesit

Komuna Vig-Mnele Shkoder.

Per dhe ne emer te Qeramarresit

Albtelecom (Perfaqesues me prokure)

Pjeter Lleshi



Zamir Cungu

